

Mbi
Auditimin e Brendshëm
Ushtruar në Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar në ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, VKM nr 212 datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, zhvilloi një mision auditimi te plotë në Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit – Bashkia Shkodër, për periudhen 1 Janar 2015-31 Dhjetor 2018 nga auditimi rezultoi:

III. Permbledhje ekzekutive

GJETJET DHE REKOMANDIMET

Gjatë kryerjes së misionit të auditimit në Drejtorinë Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit - Bashkia Shkodër, u konstatuan gjetjet si me poshte:

1. **Rekomandimet e lëna në auditivin e mëparshëm:** nuk është përpiluar plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, me afate e persona përgjegjës, kryesisht ne organizimin e brendshëm të drejtorise, përfshirë rregullore, regjistër rrisht sipas kërkesave ligjore, informim dhe monitorim.
2. **Menaxhimi financiar dhe kontrolli:** Nuk janë përgatitur plani vjetor të punës, bazuar në objektivat , detyrat, aktivitetet, indikatorët e rezultateve, grupet e punës., nuk janë përcaktuar rregullat e funksionimit brendshëm, , ka mangësi ne hartimin e regjistrit dhe planit veprimit të riskut.Nuk ka përpiluar plan për kontrollin terren. Nuk ka realizuar objektivat planifikuar. Ka mangësi në përputhjen e arsimimit me funksionin e vendit të punës, sipas organikës të personelit drejtues të drejtorisë .Ka mangësi në strukturë sipas funksioneve te Drejtorisë dhe në përshkrimin e vendeve të punës. Nuk ka ushtruar kontrollin e brendshëm të realizimit të aktivitetëve sipas planit të punës dhe kalendarit te aktivitetëve. Nuk është kryer monitorim dhe raportimi.
3. **Menaxhimi i buxhetit:** Bashkia Shkodër ka dy institucione vartësie të cilat ngritur me qëllim menaxhimin e aktivitetëve kulturore e artistike. Buxheti për kulturën nuk është bazuar në propozimet e këtyre institucioneve, janë planifikuar shpenzime për aktivitete kulturore e sportive pa patur më parë një projekt mbi menyrën e organizimit, përfituesit e mundshëm. Nuk është bërë listimi i investimeve me koston e plotë të projektit,vlera financiare dhe vlera për financim. Ka mangësi në ndjekjen dhe zbatimin e buxhetit. Nuk janë bërë planifikime 4-mujore për realizimin e buxhetit,si dhe nuk është informuar çdo 4 muaj nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues për realizimin Funksionimi i drejtorisë.
4. **Menaxhimi i projekteve:** Nuk janë ndjekur kërkesat e përcaktuara në aneksin 12 të manualit menaxhimit financiar e kontrollit, nuk janë identifikuar përfituesit e aktivitetëve, Një pjesë e projekteve janë administruar nga drejtoria pa patur kapacitetet

e nevojshme për kryerje të aktiviteteve. Ka mangësi të theksuara në organizimin e procedurave, vecanarisht përpilimin e dokumentacionit teknik të ligjor dhe në shpalljen e fituesit të projekteve, fituesit nuk janë të pajisur me licencën e lëshuar nga organet kompetente për kryerjen e aktivitetit. Nuk është përpiluar e miratuar kalendari i aktiviteteve.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Gjetje : Referuar neneve 4, 5, 11 të ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Aneksëve të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016, Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve - Bashkia Shkodër, duhej të kishte hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të funksionimit, përgatitjen e planit vjetor të punës, përpilimin e hartës proceseve të punës, hartimin e regjistrit të riskut, planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjinë dhe listë kontrollet për vizitat në terren, planin kontrollit brendshëm. Nga auditimi i kryer ka rezultuar se ka mangësi në përpilimin e rregullores brendshme dhe miratimin e saj, ka mangësi në përpilimin e regjistrit të riskut, nuk është përpiluar plani i masave për minimizimin e riskut, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në terren. Për këto veprime mban përgjegjësi Drejtore e Drejtorisë dhe përgjegjësit e sektoreve.

Rekomandim:

a. Përshtatjen dhe miratimin e rregullores së funksionimit në përputhje me shembullin 01 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016.

b. Të kërkohet asistencë e koordinatorit të riskut për Hartimin e regjistrit të riskut, hartimin e planit masave për minimizimin e riskut.

c. Bazuar në objektivat e Drejtorisë të hartohet plani vjetor i punës dhe të miratohet nga Kryetari i Bashkisë. Bazuar në planin vjetor të punës të përpilohet lista e kontrolleve për vizitat në terren.

2. Gjetje : Referuar, nenit 25 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenit 11 të ligjit 10296 dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Drejtimi duhej të kishte përcaktuar, misionin, objektivat, dhe strategjinë e Drejtorisë Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve., funksionimin e kontrollit brendshëm, hartimin dhe ndjekjen e regjistrit të riskut. Nga auditimi i kryer rezultoj se drejtimi ka mangësi në përcaktimin e objektivave, nuk ka përpiluar strategjinë e zhvillimit të funksioneve nuk ka përcaktuar rregullat e funksionimit brendshëm. Për këto veprime mban përgjegjësi Drejtore e Drejtorisë dhe përgjegjësit e sektoreve.

Rekomandim

Në rregulloren e funksionimit të drejtorisë të përcaktohen qartë strategjia e zhvillimit kulturës e sportit, funksionimi i kontrollit brendshëm, raportimi dhe monitorimi.

3.Gjetje : Në reference të aneksit nr. 12 të manualit menaxhimit financiar e kontrollit, miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016, Drejtoria për çdo aktivitet të kryer duhej të kishte përcaktuar qartë objektivin, veprimet që kryhen në realizimin e objektivave, indikatorët e performances, përfituesit, realizimin në vitin aktual, objektivat për vitin pasardhës. Nga auditimi i kryer ka rezultuar se është mjaftuar me objektiva dhe veprime të përgjithëshme, nuk janë përcaktuar përfituesit, nuk janë përcaktuar indikatorët e performances, nuk është përcaktuar realizimi në vitin aktual dhe objektivi për vitin pasardhës. Për këto veprime mban përgjegjësi Drejtore e Drejtorisë dhe përgjegjësit e sektoreve.

Rekomandimi

Për të gjitha aktivitetet që kryen drejtoria të ndiqen procedurat e përcaktuara në aneksin nr. 12 të manualit menaxhimit financiar e kontrollit, miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016.

4.Gjetje : Në referencë të nenit, 23 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”i ndryshuar, Titullari i institucionit publik është përgjegjës për ngritjen e sistemit të monitorimit e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet, duhej të kishte ngritur sistemin e monitorimit dhe informimit . Nga auditimi i kryer rezultoj se nuk është ngritur sistemi i monitorimit.

Rekomandim

Bazuar në pikën 3.4 të manualit menaxhimit Financiar e kontrollit, miratuar me Urdhërin nr 108 datë 17.11.2016 nga Ministri i Financave të ngrihet sistemi i informimit dhe komunikimit.

5.Gjetje : Në reference VKM Nr. 343 date 18.3.2015 “Për pranimin , lëvizjen paralele, periudhën provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” kreu VI , pikat 6,7. Në dosje të personelit duhet të ishin vendimet dhe dokumentet si me poshte: rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA, vlerësimin e rezultateve individuale në punë. Referuar pikës 8 të VKM 434, eprori direkt duhej të kishte bërë Konfirmimin e nëpunësit civil, nëse ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe është vlerësuar të paktën “kënaqshëm”, moskonfirmimi i nëpunësit civil con në lirim nga shërbimi civil dhe konsiderohet “mospërmbushje detyre” nga eprori direkt. Referuar pikës 13 të VKM 343 njësia përgjegjëse duhej të kishte nxjerr aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni përkatës. Nga auditimi rezultoi se në dosjen personale mungojnë :

certifikata nga ASPA “Prezantimit me Administratën Publike” për drejtoren e drejtorisë Arsim Kulturë sport dhe rini, e detyruar, ndërsa dokumentet e konfirmimit dhe ‘Akt Deklarimit’ për statusin e nëpunësit mungojnë për përgjegjësen e sektorit arsim,rini,sport, përgjegjësen e artit dhe trashigimni kulturore dhe specialisten e sektorit art, trashigimni kulturore. Nga verifikimet e dokumenteve të diplomave dhe kualifikimeve rezultojnë se: drejtoria e drejtorisë , dy përgjegjeset e sektorëve art-kulture dhe arsim-rini-sport, si dhe

specialistja e sektorit art-kulturë nuk kanë arsimimin dhe kualifikimin e duhur për vendin e punës.

6.Gjetje: Në reference të pikave, 1,2 të V.K.M nr.117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtje, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Në dosjen teknike të nëpunësit duhet të përfshihen: 1. Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje. 2. Fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit, formati i së cilës mund të jetë i ndryshueshëm, etj Certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; d) Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; e) Dokumenti i laurimit me gradë shkencore; f) Të tjera. 4. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri dhe janë pjesë përbërëse e dosjes. 5. Të gjitha dokumentet në dosje shkruhen në inventarin e saj. Fletë inventari do të firmoset nga nëpunësi dhe drejtori i personelit. Nga auditimi I kryer rezultoi se në raste janë pranuar në dosjet personale të punonjësve dokumente të fotokopjuara të pa vërtetuara nga noteri.

Rekomandim:Të bëhet plotesimi I dosjeve personale të punonjësve, të bëhet vlersimi dhe arkivimi në dojsen personale të punonjësve.

7.Gjetje: Në referencë të pikës 1,kreu I, pikës 3 kreu II të VKM nr. 109 datë 26.02.2014 “Për Vlerësimi e rezultateve në punë të nëpunësve civil” Zyrtari raportues, Kundërfirmues dhe autorizues duhej të kryente vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësin civil të kategorisë ekzekutive dhe të ulët e të mesme drejtuese. Referuar Kreut IV dhe lidhjes nr 2 “Formulari i vlerësimit për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive dhe të ulët e të mesme drejtuese”, zyrtarët e sipër cituar duhej të plotësonin formularin nr 2 për rezultatet në punë të nëpunësve civil të kategorisë ekzekutive dhe të ulët e të mesme drejtuese. Nga auditimi rezultoi se në dosje të personelit nuk rezultojnë formularët e vlerësimit të nëpunësve të drejtorisë Arsim,Kulturë,Rini dhe Sport.

8.Gjetje: Në referencë të nenit 25 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përshkrimi i vendeve të punës dhe përputhja e arsimimit dhe kualifikimit për pozicionet aktual duhej sipas funksioneve që kryen bashkia Shkodër në fushën e kulturës,arsimit e sporteve. Nga auditimi i kryer rezultoi se mungon rregullorja (përcaktimi i objektivave dhe detyrimeve të sektorëve sipas funksioneve) tek dy sektorët art-kulturë dhe arsim-rini-sport, mungojnë përshkrimet për vendet e punës të gjithë personelit , si dhe ka mangësi në përputhjen e arsimimit me funksionin e vendit të punës, sipas organikës të personelit drejtues drejtorisë.

Rekomandim: Referuar organikës dhe funksioneve të bashkisë në Fushën e Kulturës,Arsimit e Sporteve të bëhet rishikim i arsimimit dhe kualifikimeve të stafit drejtues sipas funksioneve të Drejtorisë dhe përpilimit të përshkrimit të vendeve të punës.

9.Gjetje : Ne reference te pikave 6,35,36,37 të udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm në njësitë e Qeverisjes Vendore” Drejtuesi i Funkcionit në hartimin e projekt buxhetit, duhej te kishte përcaktuar a) Misionin e

njesisë; b) Përshkrimin e programeve buxhetore dhe veprimtarive të njesisë së vetëqeverisjes vendore;

c) kategorizimin e të ardhurave vendore; d) Shpenzimet sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik, sipas aktiviteteve; e) Qëllimet e politikës të programit, objektivat e politikës së programeve, produktet e programeve dhe kostot përkatëse, shoqëruar me treguesit e performancës.

f) Planifikimin e shpenzimeve për çdo program sipas produkteve; g) Vlerësimin e kostove të politikave aktuale dhe atyre të reja, të planifikuara për financim nëpërmjet shpenzimeve buxhetore vendore vjetore dhe afatmesme;

h) Informacionin për standardet e shërbimeve të ofruara nga çdo program buxhetor dhe nivelin e përmbushjes së tyre; i) shpenzimet kapitale, listën e projekteve të investimeve për çdo program me: i. koston e plotë të projektit; ii) vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës; iii) vlerën e parashikuar për t'u financuar në vitin buxhetor korrent; iv) vlerën e mbetur për t'u financuar në vitet pasardhëse buxhetore; v) burimet e financimit.

Nga auditimi i kryer rezultoi se: në hartimin e projekt buxhetit, është përcaktuar Misionin i Drejtorise; ka hartuar qëllimin dhe objektivat e projekteve ka bërë përshkrimin e programeve buxhetore.

Drejtuari i Drejtorise, ka bërë listimin e projekteve, por nuk ka përcaktuar koston e plotë të projektit, vlerën e financuar deri në fund të vitit buxhetor paraardhës, vlerën e parashikuar për t'u financuar në vitin buxhetor korrent, vlerën e mbetur për t'u financuar në vitet pasardhëse buxhetore.

Drejtoresha e Drejtorise nuk ka bërë planifikim të ardhurash, shpenzimet e projekteve nuk i ka ndarë sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik, nuk ka përcaktuar, produktet e programeve dhe kostot përkatëse, shoqëruar me treguesit e performancës. Nuk ka dhënë Informacionin për standardet e shërbimeve të ofruara.

Rekomandime: Projekt- buxheti i ardhshëm për shpenzimet të hartohet si më poshtë:

1. Cdo fillim viti buxhetor, të behet miratimi nga bordi i kulturs i projekteve kulturore-artistike dhe kalendari i aktiviteteve për vitin e ardhshëm.
2. Përshkrimi vecmas për të gjitha programet që kërkohet financim, në mënyrë të vecantë arsyet e përzgjedhjes së programit, zona ku shtrihet, kohëzgjatja, përfituesit dhe risqet e mundshme që mund të paraqiten në zhvillimin e programit.
3. Shpenzimet duhet të paraqiten vecmas për çdo program, sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik, të ndarë sipas aktiviteteve (I gjeni publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë Financave).
4. Nëse projektet janë mbi një vit të bëhet ndarja e financimit sipas viteve (cdo vit deri në fund të projektit jepen të dhenat sa janë kryer shpenzime, sa shpenzime kryhen për vit aktual dhe sa shpenzime do të kryhen në vitet e ardhshme).
5. Shpenzimet të shoqerohen me vlerësim të treguesve ekonomik dhe të performancës.
6. Të përcaktohet burimi i financimit.
7. Të bëhet planifikimi i ardhurave sipas institucioneve të kluturës.
8. Projekt Buxheti të dërgohet zyrtarisht me protokoll.

10.Gjetje: Në referencë të pikave 31-33, shtojcave 1,2, të udhëzimit nr. 22 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarde monitorimit buxhetit, në njësitë e Qeverisjes Vendore”, Drejtoria Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, duhet të kishte kryer veprimet si më poshtë:

- Hartimin e planit katërmujor të produkteve në sasi dhe në vlerë duke respektuar tavanet e përcaktuara.
 - Mbledhjen e të dhënave në lidhje me performancën e objektivave, performancën mbi secilin produkt në fund të katërmujorit dhe krahasimin e të dhënave faktike me planin e periudhës;
 - Analizën e shkaqeve të mospërputhjeve/ shmangieve dhe marrjen e vendimeve në lidhje me veprimet korigjuese, të nevojshme për përmirësimin e situatës;
 - Në rast se një nga arsyet e shmangies ka qenë planifikimi i pasaktë atëherë është i nevojshëm rishikimi i planit dhe përgatitja e një përmbledhjeje të rishikuar katërmujore të shpenzimeve dhe realizimit të produkteve të programeve.
 - Analizën që shpjegon mospërputhjet e rëndësishme në lidhje me planin e periudhës;
 - Përmbledhjen e përditësuar të shpenzimeve dhe realizimit të produkteve;
 - Rekomandimet për veprime të mëtejshme për përmirësimin e situatës që i propozohen GMS-së për vendimmarrje;
 - Identifikimin e ndikimit të çdo ndryshimi në realizimin e planit të vitit buxhetor në përgatitjen e kërkesave për PBA-në e ardhshme;
 - Organizimin e takimeve të ekipit të menaxhimit të programit në etapa të ndryshme të procesit të monitorimit, sidomos përpara periudhave të raportimit;
 - Harmonizimin e qëndrimeve kur anëtarët e EMP-së kanë mendime të ndryshme në lidhje me situata të caktuara dhe raportimin te koordinatori i GMS-së nëse nuk harmonizohen qëndrimet;
 - Miratimin e të dhënave që hidhen në mënyrë elektronike (instrument financiar ose softëare i përdorur për këtë qëllim)/data bazën e njësisë së vetëqeverisjes vendore për monitorimin e zbatimit të buxhetit.
 - Mbi bazën e produkteve të përcaktuara drejtuesi i programit ka përgjegjësi të vlerësojë risqet që ndikojnë në arritjen e këtyre produkteve, mënyrën e trajtimit të tyre, si dhe kostot për minimizimin e risqeve. Risqet renditen sipas impaktit në realizimin e objektivit sipas të cilit është i lidhur produkti dhe diskutohen në Grupin e Menaxhimit Strategjik.
 - Të përpiloje raporte 4 mujore sipas shtojcës 2 dhe të informojë nëpunësin autorizues.
- Nga auditimi i kryer ka rezultuar se kërkesat e mësipërme ligjore nuk janë respektuar.

Rekomandimi : Me fillimin e vitit buxhetor, Drejtuesi i programit kulturës të hartojë planin katërmujor të shpenzimeve, në sasi dhe në vlerë duke respektuar tavanet e miratuara, hartimin e afateve kohore sipas shtojcës 1 dhe hartimin e raporteve katër mujore sipas shtojcës 2 të udhëzimit nr. 22.

11.Gjetje: . Në referencë të pikës II të V.K.M nr. 1173 datë 6.11.2009 “Për caktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike te pavaruara” për kryerjen e aktivitetetve kulturore duhej te ishte ndjekur procedura si me poshte:

- Titullari i institucionit urdhëron, me shkrim, blerjen e shërbimit e të mallrave, për zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve kulturore, sociale dhe artistike nga operatorët e fushës, duke parashikuar, për çdo rast, objektin, nevojën e kryerjes së programit, fondin limit dhe përbërjen e komisionit, për ndjekjen e procedurave.

- Përzgjedhja e operatorëve të specializuar, në varësi të llojit të ngjarjes, të bëhet sipas a) Përvojës në organizimin e ngjarjeve; b) Çmimit të ofruar nga operatorët e specializuar.
- Komisioni për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumenteve përbëhet nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë specialistë të fushës.
- Komisioni, brenda një periudhe kohore 5-ditore nga data e daljes së vendimit, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare, operatorëve/agjencive të specializuara ftesën për negociata, e cila duhet t'u dërgohet të paktën dy operatorëve.
- Në ftesën për negociata duhet të përcaktohen objekti i programit, ngjarjes, nevoja e kryerjes së programit/ngjarjes, fondi limit dhe data përfundimtare për paraqitjen e ofertës nga operatorët dhe agjencitë.
- Komisioni pret, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata, konfirmimin nga operatorët/agjencitë e specializuara për vazhdimësinë e negociatave, i cili shoqërohet me çmimin përkatës për kryerjen e programit/ngjarjes, nga operatorët/agjencitë e specializuara. Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave vijnë në një ditë të vetme, të mbyllura dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit.
- Komisioni, pas analizimit të ofertave të paraqitura, përzgjedh, në bazë të pikëve, operatorët/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, si dhe harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin ia paraqet titullarit të institucionit.
- Titullari i institucionit, në bazë të rekomandimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit, vendos, brenda 2 ditëve nga data e paraqitjes së rekomandimit, lidhjen e kontratave me operatorin/agjencinë e specializuar, për organizimin e ngjarjes.

Nga auditimi I kryer ka rezultuar se:

- Nuk është krijuar komisioni me specialist perkates per pergatitjen e dokumentacionit nevojshme dhe kryerjen e procedurave. Nuk është ndjekur procedura e mësipërme, por është mjaftur me ftese te hapur, pa përcaktuar qarte, specializimin per te kryer aktivitetin, kapacitet teknike, pervojën e meparshme cmimin me te ulet etj.
- Dokumentacioni nuk eshte paraqitur ne rruge zyrtare me protokoll,
- Në vlersimin e opereve nuk është marrë në konsideratë specializimi I tyre, konkretisht për Festival JAZZ për vitin 2016 është fituar nga ACLI- IPSIA e cila nuk ka paraqitur dokumentacion ligjore si Shoqatë e specializuar dhe e licensuar në fushen e muzikës, ndërsa për vitet 2017-2018, është fituar nga Shoqata Rrok jakaj e cila nuk ka paraqitur dokumentacion ligjore si Shoqate e specializuar dhe e licensuar në fushen e muzikës. Për “Ndermendje ne vitet 2018-2018 është fituar nga fonadacioni “ARTE” e cila nuk ka paraqitur dokumentacion ligjore si Fondacion I specializuar në fushen e muzikës.
- Vlersimi dhe shpallja e fituesit është bërë nga bordi i kultures i cili me ligj nuk e ka në kompetencë vlersimin e fituesit aktivitiit. Nga krahasimi i vitit 2017 me vitin

2018 për aktivitetin Festival JAZZ në vitin 2017 janë shpenzuar 1.000.000 lek ndërsa në vitin 2018 për 1.500.000 lek me një rritje të shpenzimeve prej 50%, ndërsa numri i personave që do të kryejnë aktivitetin ka qenë pothuajse i njëjte. Në preventivat e viteve 2017 e 2018, një zë shpenzimi ka qenë marrje me qira piano dhe për marrjen me qira nuk është paraqitur kontrate qiraje.

- Kontrata e lidhur me fituesin, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në kodin civil
- Realizimi dhe monitorimi i aktivitetit është kryer nga Pergjegjëse e Trashigimisë kulturore.
- Për aktivitetet e kryer nuk është përpiluar raport me shkrim për Drejtoreshë e Drejtorisë.
- Nuk janë evidentuar përfituesit për aktivitetet e zhvilluar, nuk janë analizuar kosto-përfitimet

Veprimet e mesipërme bien në kundërshtim me pikën II të V.K.M nr. 1173 datë 6.11.2009 “Për caktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike të pavaruara”, pika 3 e nenit 22 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi Përgjegjëse e Artit dhe Trashigimisë kulturore dhe Drejtoreshë e Drejtorisë Kulturore, Rinise dhe Sporteve.

Rekomandimi nr. 11: Në kryerjen e aktiviteteve kulturore të ndiqet procedura si më poshtë:

- Bazuar në vendimet e Bordit të Kulturës, për miratimin e aktiviteteve kulturore dhe kalendarin e aktiviteteve, të zbatohen kërkesat e II të V.K.M nr.1173 datë 6.11.2009.
- Të hartohet dokumentacioni, duke përcaktuar qartë, specifikimet teknike të shërbimit, kapacitetet teknike të ofruesit shërbimit, paraqitjen e kontratave për shërbime që nuk i ofron operatori.(të përfshihet baza materiale dhe shërbimi në një fond limit të vetëm).
- Të bëhet shpallja në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.
- Pranimi i dokumentacionit të bëhet në zarf të mbyllur nëpërmjet zyrës me një ndalesë.
- Vlersimi i ofertave nga komisioni të bëhet në të njëjtën ditë në prani të operatoreve pjeëmarrjës.
- Në përfundim të vlersimit të ofertave të hartohet relacioni dhe të dërgohet për miratim pranë kryetarit të Bashkisë.

12.Gjetje: Në referencë të neneve 59, 61 të V.K.M nr 914 datë. 29.12.2014 “Për përcaktimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Sektori i Arsimit Rinise e sportit, duhej të kishte për caktuar qartë specifikimet teknike sipas zerave të shpenzimeve, duke përcaktuar qarte dhenat e mallit apo shërbimit si dhe fondin limit, Njësia e prokurimit duhej të kishte përgatitur dokumentacionin teknik dhe ligjor, përfshirë dhe kapacitetin për kryerjen e aktivitetit ose

nenkontraktimin në rasat kryerjes shërbimit nga te trete (psh. Akomodimin ose transportin). Në referencë të pikës 1 V.k.M nr. 595 datë 29.12.1993 “Për kriteret e shpalljes e konkurseve me karakter kombëtar e lokal” i ndryshuar”. Për aktivitetet me karakter kombëtar e lokal Këshilli Bashkiak, duhej të kishte marrë vendim të veçante për zhvillimin e aktiviteteve .Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi përkatësisht e Drejtore e Drejtorise Kulturës, rinisë dhe Sporteve, përgjegjëse e Sektorit Arsim Sportit dhe Rinise dhe Njësia e Prokurimit për përgatitjen e dokumentacionit te prokurimit.

Rekomandime:

a.Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit të hartojë specifikimet teknike sipas kërkesave të udhëzimeve Agjensise Prokurimit Publik, Njësia e prokurimit publik të përfshije në dokumentacionin per operatorin pjesmarrës dhe kapacitetet teknike te ofrimit shërbimit ose kontratën e nenkontraktimit.

b.Për aktivitetet e kryera nga Dretjoria E Kultures Rinise e Sportit të bëhet evidentimi analitik i personave pjesemarres, i personave perfitues nga fondet si dhe të dokumentohen me shkrim realizimi i objektivit.

13.Gjetje: : Në referencë të nenit 28, pika 3 të ligjit nr 10352 datë 18.11.2010 “Për artin e Kulturën” i ndryshuar. Ku shprehimisht thuhet “Përbërja e bordit artistik të institucionit publik vendor miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore. Anëtarët e bordit kanë mandat 4-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.”, bordi i kultures duhej te ishte ngritur në bazë të nenit 28 të këtij ligji. Nga auditimi i kryer ka rezultuar se ngritja miratimi dhe funksionimi i Bordit Kultures është bërë në mbështetje të dispozitave ligjore të shfuqizuara. Për këto veprime mban përgjegjësi Drejtore e Drejtorisë Kulturës Rinisë e Sporteve.

Rekomandim: Fillimin e procedurave për shkarkimin dhe emërimin e bordit te kulturës sipas kërkesave te 28, pika 3 të ligjit nr 10352 datë 18.11.2010 “Për artin e Kulturën” i ndryshuar.

14.Gjetje: Në referencë të neni 28, pika 1 të ligjit nr 10352 datë 18.11.2010 “Për artin e Kulturën” i ndryshuar.Ku shprehimisht thuhet:“Institucionet publike vendore të artit e të kulturës janë institucione buxhetore, që krijohen ose shndërrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji me nismën e vullnetin e pushtetit vendor dhe janë në varësi të njësisë së pushtetit vendor”.Nga auditimi i kryer rezultoi se drejtuesit e Administratës Kultures dhe Teatrit “Migjeni” janë emruar.Për këto veprime mban përgjegjësi Drejtore e Drejtorise Kulturës, Rinisë e Sporteve, për mosfillimin e procedurave për zgjedhjen e Drejtuesve të Artit e Kulturës.

Rekomandim:

Fillimin e procedurave të zgjedhjes se Drejtuesve institucioneve artit e kultures sipas nenit 28, pika të ligjit nr 10352 datë 18.11.2010 “Për artin e Kulturën” i ndryshuar. Miratimin e statusit te institucioneve artit e kulturës.

Njësia Auditimit Brendshëm

Bashkia Shkodër